



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

PROGRAMI I INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT TE PLATFORMËS

Qëllimi i informimit

- Përshkrimi i Platformës
- Titulli i Projektit: Avancimi i Diplomave dhe Zhvillimi i Kapaciteteve Universitare në Shqipëri (GRADUA)

Veprimi: Ngritja e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë (CBHE)

Projektit Gradua, ka si qëllim të krijojë bashkëpunime konkrete midis Universitetit dhe tregut të punës përmes krijimit të një platforme të përbashkët, e cila do të sigurojë mjete të reja rekrutimi. Platforma bën të mundur ndjekjen e të diplomuarve dhe punësimin e tyre duke u mbështetur në praktikat më të mira të BE-së.

Qëllimet e informimit mbi Platformën

Informimi ka si qëllim që:

- të informohen të gjithë studentët e UPT, të cilët janë në prag diplomimi mbi projektin Gradua dhe rëndësinë e tij;
- të parashtrijë rrugën e regjistrimit në platformë të studentëve të sapodiplomuar;
- të promovojë dhe udhëzojë studentët e sapodiplomuar për plotësimin e formularit të aplikimit;
- të udhëzojë studentët për të ndjekur në mënyrë aktive platformën, me qëllim që të krijojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë interaktive dhe të vazhduar me kompanitë, të cilat operojnë në fushën inxhinierike;
- të punësojë studentët e UPT-së pranë kompanive të cilat operojnë në fushën inxhinierike;

Çfarë e bën të veçantë këtë platformë/ benefitet:

- Me anë të plotësimit të pyetësorit në platformë mundësohet gjenerimi automatik i CV në formatin EUROPASS
- Studentët përdorin pa pagesë shërbimin e platformës
- Ka një qasje të lehtë në informacion mbi mundësitë e punës/internshipit
- Krijohet marrëdhënie e drejtpërdrejtë me kompanitë, të cilat operojnë në fushën inxhinierike
- Mundësohet më me efikasitet udhëheqja e karrierës dhe punësimit.
- Mundësi më të mira zgjedhjeje të cilat vijnë si pasojë e vizibilitetit të dyanshëm të ofertës (kompani-studentë)
- Kryhet certifikimi i karrierës akademike
- Mundësi për të promovuar Universitetin

Identifikimi i përdoruesve

- Studentët në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit
- Kompani të ndryshme që operojnë në fushat e profilit inxhinierik
- Universiteti Politeknik i Tiranës
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Përse është e nevojshme platforma për përdoruesit

Platforma bën të mundur ndjekjen e të diplomuarve dhe punësimin e tyre duke u mbështetur në praktikën më të mirë të BE-së.

- Projekti ka për qëllim të krijojë sinergji konkrete midis Universitetit dhe tregut të punës përmes ofrimit të një instrumenti unifikues në dispozicion të të dy përfituesve për vlerësimin e të diplomuarve dhe performancave të sistemit arsimor dhe sigurimin e mjeteve novatore të rekrutimit.
- Gjithashtu përqendrimi i fuqishëm në ndërtimin e kapaciteteve do të lejojë njohjen e shpejtë të përfituesve shqiptarë nga mjetet dhe metodologjitë më të avancuara për të drejtuar sondazhin dhe analizat mbi arsimin e lartë dhe tregun e punës në Shqipëri, në përputhje me tendencat e BE-së. Risia qëndron në mundësinë për të siguruar përfituesit në një kohë të shkurtër (trajtime intensive) me njohuri të mëdha të bazës.

Puna me partnerët e disseminimit - komunikimi

- Zyra e Këshillimit të Karrierës
- Drejtues të fakulteteve të UPT-së: Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i

Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave

- Përgjegjësit e departamenteve të secilit fakultet
- Udhëheqësit e diplomave pranë çdo departamenti
- Personat përgjegjës të network-eve formale dhe joformale pranë çdo fakulteti

Përdoruesit	Partnerë te brendshëm në diseminim Fakultete, drejtues, network	Rëndësia e përfshirjes së partnerit
Studentët e sapodiplomuar të UPT	Zyra e këshillimit të karrierës	Përcjell informacionin nga burimi zyrtar institucional
	Drejtues të fakulteteve, Përgjegjës të departamenteve	Organizimin dhe planifikimin e takimeve me studentët
	Udhëheqësit e diplomave pranë cdo departamenti	Rrisin besueshmerinë e platformës te studentët, të cilët janë nën udhëheqjen e tyre
	Personat përgjegjës të network-eve formale pranë çdo fakulteti.	Përcjellin elektronikisht informacionin te palët e interesuara

Përputhja e platformës me qëllimet e partnerëve në diseminim, (përse do të bashkëpunonin, çfarë mund të ndihmojë ose pengojë gadishmërinë e tyre në bashkëpunim për informimin rreth platformës) ?

Kjo platformë është e rëndësishme për partnerët në diseminim në këto drejtime:

- Zyra e këshillimit të karrierës: kthehet në urë lidhëse midis studentëve të diplomuar dhe tregut të punës, punësim më eficient dhe i vlerësueshëm i studentëve të UPT-së.
- Drejtues të institucionit/fakulteteve: shërben për studime të ndryshme në lidhje me cilësinë e studentëve në dalje si dhe me përgatitjen e programeve të studimit konform kërkesave të tregut të punës
- Udhëheqësit e diplomave: shërben për të orientuar studentët drejt fushave kyçe dhe më me interes të industrisë.

Ngritja e një marrëdhënieje të vazhdueshme me partnerët në diseminim në mënyrë që platforma të përfshihet në kanalet e tyre të komunikimit.

Nëpërmjet takimeve periodike formale me drejtuesit e fakulteteve të UPT- së, të cilët do të përcjellin shpërndarjen e platformës vertikalisht te përgjegjësit e departamenteve dhe stafit akademik e më pas këta të fundit pranë studentëve të cilët presin të diplomohen.

Nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës së UPT- së si dhe rrjeteve elektronike formale të cilat do të bëjnë rikujtesën në mënyrë periodike mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e aplikimit në platformën GRADUA

Vlerësimi i procesit të diseminimit

Qëllimi	Arritja e qëllimit	Treguesi i matshëm për qëllimin
Informimi mbi platformën GRADUA dhe rëndësinë e saj	Mbërritja e informacionit pranë stafeve akdemike dhe studentëve në prag diplomimi	Përqindja e stafit akademik dhe studentëve në prag diplomimi, pjesëmarrës në takimet e informimit mbi platformën GRADUA
Parashtrimi i rrugës së regjistrimit në platformë për studentët e sapodiplomuar	Ngritja e një procedure efikase e cila ndihmon në regjistrimin e studentëve të sapodiplomuar në platformën GRADUA	Numri i regjistrimeve të suksesshme në platformë
Promovimi dhe udhëzimi i studentëve të sapodiplomuar për plotësimin e formularit te aplikimit	Ngritja e një procedure efikase e cila ndihmon dhe udhëzon studentët e sapodiplomuar në plotësimin e pyetësorit GRADUA	Numri i pyetësorëve GRADUA të plotësuar me sukses
Punësimi i studentëve dhe Alumni të UPT-së pranë kompanive të cilat operojnë në fushën inxhinierike.	Duke implementuar në mënyrë efikase platformën GRADUA	Numri i të punësuarve të studentëve dhe Alumni të UPT-së

Plani i punës për informimin mbi platformën

Veprime afatshkurtra, kohëzgjatja dhe personat përgjegjës

Nr.	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Data dhe vendi	Materiale	Madhësia e grupit pjesëmarrës	Lloji i grupit të pjesëmarrësve
1.	<p>Takime me drejtues dhe përgjegjës të departamenteve të fakulteteve të UPT-së</p> <p>1.Fakulteti FIM 2. Fakulteti FIM 3.Fakulteti FIE 4.Fakulteti FTI 5.Fakulteti FIN 5.Fakulteti FAU 6.Fakulteti FGJM 7.Fakulteti FIMIF</p> <p>me qëllim planifikimin e diseminimit.</p>	Zyra e karrierës	06.01.2020 ,15.01.2020 Dekanatet	Materiale informuese	10	Drejtues dhe përgjegjës të departamenteve të fakulteteve dhe staf akademik
1.	Takim me studentët në prag diplomimi të Fakultetit FIM	Zyra e karrierës	10.01.2020 Klasa leksionesh	Materiale informuese	50 studentë	Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të Fakultetit FIM
2.	Takim me studentët në prag diplomimi të Fakultetit FIE	Zyra e karrierës	09.01.2020 Klasa leksionesh	Materiale informuese	50 studentë	Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të

						studimit të Fakultetit FIE
3.	Takim me studentët në prag diplomimi të Fakultetit FTI	Zyra e karrierës	08.01.2020 Klasa leksionesh	Materiale informuese	50 studentë	Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të Fakultetit FTI
4.	Takim me studentët në prag diplomimi të Fakultetit FIN	Zyra e karrierës	13.01.2020 Klasa leksionesh	Materiale informuese	50 studentë	Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të Fakultetit FIN
5.	Takim me studentët në prag diplomimi të Fakultetit FAU	Zyra e karrierës	14.01.2020 Klasa leksionesh	Materiale informuese	50 studentë	Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të Fakultetit FAU
6.	Takim me studentët në prag diplomimi të Fakultetit FGJM	Zyra e karrierës	15.01.2020 Klasa leksionesh	Materiale informuese	50 studentë	Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të Fakultetit FGJM
7.	Takim me studentët në prag diplomimi të Fakultetit FIMIF	Zyra e karrierës	16.01.2020 Klasa leksionesh	Materiale informuese	50 studentë	Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit të Fakultetit FIMIF
	Open Day Informim me drejtuesit e Fakulteteve të UPT-së mbi rëndësinë dhe organizimin e open day	Zyra e karrierës	17.01.2020	Materiale informuese		Zyra e karrierës ,drejtues të fakulteteve të UPT-së

	Open day	Zyra e karrierës në bashkëpunim me drejtori të ndryshme të Rektoratit	20.01.2020 Ambjente të UPT-së	Prezantimi me PPT Platforma Gradua, Fletëpalosje	<ul style="list-style-type: none"> - Studentë në prag diplomimi të ciklit të parë dhe të dytë të studimit në UPT - Përfaqësues të studentëve të punësuar si rezultat i regjistrimit në platformën GRADUA - Sekretar të mësimore - Përfaqësues të kompanive regjistruar në platformën GRADUA - Përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë - Staf akademik
--	----------	-----------------------------------------------------------------------	----------------------------------	--------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Burimet, materialet

Prezantimi me PPT Platforma Gradua, Fletëpalosje

